**UDHËZIM**
**Nr. 45, datë 31.10.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 5.3.2010, "PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SISTEMIN E VIDEO SURVEJIMIT NË NDËRTESA DHE MJEDISE TË TJERA**

Në mbështetje të nenit 18 dhe shkronjës "f", të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

1. Modeli standard i tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistem survejimi, titulluar "Zonë e mbikëqyrur me kamera", ndryshon sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
**Besnik Dervishi**

# ZONË E MBIKËQYRUR ME KAMERA

Subjektet e të dhënave personale, mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar pranë:

_____

**(Emri i Kontrolluesit)**

_____

**(Kontaktet e Kontrolluesit)**

*Në rast keqpërdorimi të të dhënave personale apo cënim të privatësisë nëpërmjet sistemit të kamerave, subjektet kanë të drejtën të ankohen pranë:*

***Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.***

*Nr. Jeshil: 0800 20 50 www.idp.al info@idp.al*